

V E N D I M
Nr.474, datë 10.7.2003

**PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË STEMËS SË REPUBLIKËS, SI DHE RAPORTIN
E PËRMASAVE TË SAJ**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 8 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, për mbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, me propozimin e Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Stema e Republikës, kudo që ajo përdoret, në emërtimet e institucioneve shtetërore, në aktet zyrtare që ato lëshojnë, në kartat e identitetit të shtetasve apo në çdo dokument tjetër paraqitet me pamje standarde, në përmasat dhe të gjitha elementet përbërëse të saj, në përputhje me kërkesat e pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002. Pamja e stemës së Republikës dhe raportet e përmasave të secilit element të stemës janë dhënë në figurën 1 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë e tij.

2. Kur stema e Republikës shërben si emërtim në hyrje të institucioneve, përdoret tabela standarde në përmasat 500x700 mm, me vendosje horizontale. Fusha e tabelës të jetë me ngjyrë të artë, ndërsa shkrimi me ngjyrë të zezë. Në pjesën e sipërme të tabelës shkruhet me shkronja kapitale “Republika e Shqipërisë” dhe, nëse ka, në rreshtat e tjera shënohen strukturat vartëse në linjë vertikale. Në qendër të tabelës vendoset stema e Republikës, me përmasa 100x150 mm, ndërsa poshtë saj, gjithashtu me shkronja kapitale, vihet emërtimi i institucionit, sipas modeleve të dhëna në figurën 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Përshkrimi gjeometrik i vulave, ku përdoret stema e Republikës nga institucionet shtetërore, është si më poshtë vijon:

a) Diametri i vulës së njomë, të thatë ose prej dylli është standard 40 mm. Përjashtim bëjnë vulat e sekretarive të institucioneve qendrore, që mund të jenë me diametër më të vogël dhe vulat e thata të noterëve, që, për arsye teknike, janë më të mëdha nga standardi i mësipërm.

b) Stema e Republikës vihet kurdoherë në qendër të vulës, me përmasa të ndryshueshme, në varësi të të dhënave që përmban vula.

c) Në rrethin e jashtëm, në krye të vulës shënohen fjalët “Republika e Shqipërisë” dhe më pas vijon renditja administrative hierarkike, deri tek institucioni në fjalë dhe vendndodhja e selisë së tij. Shkronjat e vulës janë kapitale, me madhësi të ndryshueshme, por kurdoherë të dukshme, siç janë paraqitur në figurën 3 të shtojcës.

4. Stema e Republikës, kur përdoret në aktet zyrtare shkresore, vendoset në krye të fletës format A4, në përmasat 10/15 mm, ndërsa poshtë saj shkruhet me shkronja kapitale “Republika e Shqipërisë” dhe në rreshtat e mëposhtëm, institucionet përkatëse. Në rastet kur stema e Republikës nuk është me ngjyrë, atëherë përdoret stema me konture bardhezi, por jo duke u fotokopjuar stema me ngjyrë bardhezi. Përdorimi i stemës me ngjyrë dhe asaj bardhezi do të bëhen sipas modeleve “a” dhe “b”, të figurës 4 të shtojcës. Stema e Republikës vihet në vend të dukshëm edhe në certifikatat e identifikimit të shtetasve, në dëftesa ose diploma shkollore, në shpallje publike me karakter zyrtar të organeve shtetërore, në licenca etj.

5. Institucionet shtetërore, të niveleve të ndryshme, kur është fjala për komunikimet jozyrtare me të tretë, mund të përdorin edhe logot e tyre në botime të ndryshme, në reklama etj.

6. Ngarkohen administratat e të gjitha organeve dhe të institucioneve shtetërore dhe subjektet e licencuara për prodhimin e vulave ose të botimeve, që i përmbajnë këto vula, për zbatimin e këtij vendimi.

7. Afatet e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këtë vendim janë deri në tre muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

1.5

0.028

0.05

0.224

0.30

0.32

0.05

0.028



1

0.028

0.075

0.25

0.06

0.9

0.137

0.05



Vulat Zyrtare



Vulë e Thatë

Fig.3



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E RENDIT PUBLIK
DREJTORIA E POLICISE QARKUT TIRANE

Nr.....Prot.

Tiranë.....

Fig.4/a



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E RENDIT PUBLIK
DREJTORIA E POLICISE QARKUT TIRANE

Nr.....Prot.

Tiranë.....

Fig.4/b